

**PARASHTESE TEKNIKE
E PROJEKTIT
NDERTIM E RIKONSTRUKSION URASH BASHKIA
TROPOJË**

-I- TE PERGJITHSHME

Urat qe do te ndertohen te reja apo dhe ato qe riparohen apo rikonstruktohen do i sherbejn komunitetit te Njesive Administrative Bujan, Llugaj, Fierze, Lekbibaj, Tropoje dhe Bytyç. Ne kete Projekt perfshihen edhe urat kembesore ne disa fshatra te cilat kryesishte sherbejne per kalimin e fëmijve nga lagjet për në shkolla. Hartimi i projekteve eshte realizuar nga Drejtoiria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit pranë Bashkisë Tropojë. Per projektet Tipe siç jane ndertimi i Uravbe Hd-3 apo 4 m jane projekte tipe te realizuar me pare ne disa fshatra te rrethit Tropoje dhe nga grupi i projektimit ne baze te matjeve topografike ne terren eshte realizuar projektimi i shpatullave te ketyre urave.

Projekti per Rikonstruksin te disa urave eshte mbeshtetur ne gjendjen ekzistuese te tyre duke plotsuar me shtresa Beton/Arme disa ura ku mbeshtetja eshte pjeserisht ne formacion shkembore por nga grryerja Ballnat e urave jane hava duke shtuar ketu edhe ndertimin eshpatullave te rrezuara nga vershimet e jashtëzakshme te ujrave nga rreshjet e atmosferike të datave 16 e 17 Shatator 2022.

Keto Projekt - Preventivave jane realizuar me kerekese te Njesive Administrative të lartëpërmendura ne kuader te Emergjencave Civile te cilat kanë ardhur nga permbytjet rreshjeve qe trajtuam me larte krahas shume demtimeve tjera ne Blegtori, Bujqësi e Bletari ku vlen per te theksuar se nga keto rreshje në 7-te Njesit Admiministrative te Bashkisë Tropojë 7.3 Ha toke jane elimininur perfundimishte nga grryerjet duke shtuar ketu me dhjetra hektar te mbuluar me inerte me nje trashsi qe varoin 10 ~ 70cm.

-II- SHTRIRJA – GJEOGRAFIKE

Zona ku do te relizohen ndertimet shtrihet ne te gjithë territorin e Bashkisë Tropojë dhe në përgjithësi do ti sherbejë më shumë se 50% të popullsisë së kësaj Bashkie siç po i pasqyrojme me poshte:

- Njesia Administrative Bujan. Ndertim i Shpatullave te Ures së Dezdarit, Rikonstruksioni ures Pasarel mbi lumin e Valbones ne në vendin e quajtur Livadhi i Turkut.
- Njesia Administrative Llugaj. Në fshtin Luzhe ndertim i ures Hd-15m tip "BELI"ne (Lagja Neza), Ndertim shpatulla ure mbi Vitalin (Lagja Madan), Ndertim Ure kembesore Hd = 6m ne Lagjen Gegaj, Ndertim i ures kembesore Hd = 3 x 6m ne Lagjen Vushniqe.
- Njesia Administrative Tropoje. Ndertim ure e re ne fshatin Babin ne Lagjen Baliaj me Hd = 4 m, ndertim i shpatullave te ures nefshatin Shumice (degzimi nga rruga nacionale per Q.Morine).
- Njesia Administrative Fierze. Në fshtin T'pla ndertim shpatulla ure ne perroin e Kënetës ne Buçpapaj, Bashaj, Ndertim shpatulla ure e monolizim elemenetesh B/Arme Lagja Malaj, Degzimi për fshatin Degë. në fshatin Degë Ndertim i ures Hd = 4.0m prroi i Kenetes,

- ndertim ure kembesore Hd = 4m ne Lagjen Hasanaj. Ndertim shpatulla mbi uren e kënetës rruga kryesore.
- Njesia Administrative Margegaj. Ndertim ure tip "BELI" ne Lagjen Fushe Lumi dhe ndrtim ure Hd= 2.5 m ne Provali fshati Margegaj.
- Njesia Administrative Lekbibaj. Ndertimi i dy Urave kembesore Hd = 4m e 5m në fshatin Palç dhe 2 x 5m ne fshatin Gjonpepaj.
- Njesia Administrative Bytyç. Ndertim i ures kembesore Hd = 2 x 6m ne Lagjen Tutaj. Ndertim kalim prroni me ura te vogla Hd = 2.5m ne 2 kalime Lagja Isufaj e 1 kalim në Lagjen Lajthize, Ndertim shpatulla ure e shtrese B/Arme ne Uren Lagja Mashe, ndertim Ure Hd =3m ne fshatin Rushte, ne Rrugen Nacionale Kam - Qafe Prushi (ne Lagjen Kepenek) dhe Ure në Qender Zogaj Hd = 4m. Ndertim shpatulla urah ne Lagjen e Xhuxhë e në Lagjen Mahall e Eper.

-III- KUSHTET KLIMATIKE

Zona ne te cilen do te ndertohen objektet(urat) shtihet ne gjithe territorin e Bashkisë Tropojë e cila bë pjesë ben pjese ne zonen Klimatike Kontinentale Mesdhetare me dimer te ftohte dhe vere te nxehte e te thate. Temperatura mesatare shumevjecare, te Janarit muajt me te ftohte te vitit eshte -6°C . Gjate muajve Korrik e Gushte temperatura mesatare e ajrit arrin deri 28°C . Ne dimri ka ngrica dhe reshje bore per nje periudh prej 3 – 4 deri muaj (Nentor – Shkurt). Rreshjet mesatare shumevjerçare arrijne deri 1280 mm dhe rreshjet maksimale deri 257 mm në 24 ore.

Ne pjesen me te madhe te zonave ku shtrihen objektet niveli i ujrave nenëtoksore eshte aferishte 3.8m dhene kohe vere mund te jete 4.5 ~ 5m.

Nga ana gjeologjike Malet janë të përbëra nga formacione konglomerati shpeshtë të shkrihtë, ranore dhe argjilore.

Te dhenat per reshjet jane te marra nga burimet arkivore të Institutit Hidrometerologjik të Tropojës.

-IV- GJENDJA EKZISTUESE E URAVE

Zona ne te cilen do te ndertohen objektet(urat) shtihet ne gjithe territorin e Bashkisë Tropojë ato do ti sherbejnë komunitetit, si dhe biznesit qe zhvillohet ne kete zone per tu lidhur lagjet ne mes tyre, fshatrat me rruget nacionale Bajram Curri – Qafe Morrin, B, Curri – Has, B. Curri – Tirane etj.

Mbeshtetur ne keto te dhena grupi i projektimit beri piketimin paraprak te urave te reja ne vend si dhe konkludoi mbi nevojën e seciles prej tyre se çfare elementesh do përfshihen ne punimet e rikonstruksionit. Ne hartimin e Projekt - Preventivave është punuar me synim permirsimin e difekteve te objekteve ekzistuese, pasi ne disa prej objekteve ne fjale demtimet kane ardhur si rezultat i difekteve ne zbatim kryesishtë në thellesin e themeleve.

Sipas zgjidhjeve te dhena ne kete projekt permirsohet edhe hyrja e dalja ne keto ura me mbushjet qe do të realizohen dhe shtresat prej çakulli ne 2 anet e çdo ure.

-V- ZGJIDHJA TEKNIKE E PROJEKTIT

Ne zgjidhjen teknike te projektit jane marre parasysh te gjitha problemet e konstatuara nga grupi projektues si dhe problemet qe ka patur kjo gjate shrytezimit dhe rikonicionit.

Per hartimin e ketij projekti jane marre ne konsiderate :

- Fakti se urat kembesore ekzistuese ne gjitha fshatrat qofte me trare druri qofte me trare metalik janë eliminuar 100% kjo dhe per faktin se nuk kane patur bazamente por kanë qenë të mbeshetura direkt në tokë të pa lidhura me bregun.
- nga grupi i Projektimit u hartuan Projekte Tipe me Konstruksion metalik.
- Per realizimin e qëndrueshmëris u realizua Projekti Tip per ura kembesore me 2 trare metalik gjatsore dhe profile metalike "U" terthore te cile do te lidhen me vida ose me saldim. Lidhja e ketij konstruksioni me ballanat e betonit do te realizohet me saldim ne pllak te lidhura me betonin ose me prezhinjer sipas detjeve te dhena ne projekt.
- Jane parshikuar per gjitha urat kembesore Parmak metalik sipas vizatimeve ne projekt.
- Gjendja teknike e çdo ure te demtuar nga rreshjet e jashtëzakonshme e vershimet e ujrave jashtë shtratit te tyre per nje periudhe kohere mbi 48 ore ne muajn Shtatore 2022
- Për ndertimin e urave te reja u studiuuan pikat me te volitshme si nga ana e formacioneve gjeologjike ashtu edhe nga zgjidhja funksionale me efikase.
- Rekomandimet perkatese te inxhinierit gjeolog.
- Mbi bazen e gjesive faktike te urave jane llogaritur volumet e punimeve qe do te kryhen ne secilen kryesishte ne mbrojtjen e Ballbave.
- Jane parshikuuar mbushjet me material shkembore dhe shtresat e çakullit ne dy anet minimlishte nga 10m per çdo ane.
- Jane parshikuuar germime për themele me makineri.
- Jane parashikuuar për perpunim apo skuadrim te themeleve germime me krah.
- Është parshikuuar ndertimi i murit mbrojtës ne shpatullen e djathte te ures se Dëzdarit (Ura e Tankeve).
- Eshte parashikuuar rehabilitimi i pjeses në funksion te ures tip "Pasarel" ne vendin e quajtur Livadhi i Turkut.
- Keto zgjidhje jane te pasqyruar ne projektet e hartuar nga ana jone.

VI- ORGANIZIMI I PUNIMEVE

- Punimet ne Ura mund te kryhen ne periudhen Qershore - Nantore .
- Fillimisht te realizohen Ballnat dhe Shpatullat e Urave ne menyre qe rritja e nivelit ujrave ne sezionin e vjeshtes të mos bëhet pengesë per realizimin e Projektit. Mbistrukturat e Urave kryesishtë ato me konstruksione metalike munde te realizohen ne çdo kohe.
- Mbushja me material shkembore pas mureve te realizohet paralelisht me ngritjen e mureve.
- Tombinot e betonit duhet te vishen me shtrese betoni sipas projektit para realizimit te mbushjeve.

- Konstruksionet metalike duhet detyrimisht te lidhen me ballnat e urave me vida apo saldime (shif detajn e projektit) para montimit te shtresave prej druri.
- Lyerja me boje vaji e konstruksioneve metalike te realizohet pasi siperfaqet metalike te jene te pastruara me furçe hekuri nga ndryshku.
- Landa drusore te lyhet me solucione kunder ujembajtjes para montimit ne objekt.
- Germimet e dheut jane parashikuar me krahe dhe mekanizma.
- Jane parashikuar betone e b/betone C-12/15, C-16/20, C-20/25, C-25/30.

Keto punime do te kryhen nen mbikqyrjen e dhe do te merren ne dorezim nga supervizori dhe perfaqses te Bahkisë Tropojë.

VOLUMET KRYESORE JANE:

Nr	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia
1	Germim per themele me esk.025m3	m ³	942
2	Germim per themele me krah	m ³	284
3	Struktura buto/betoni C-12/15 me 20% gure	m ²	955
4	Struktura monolite betoni C – 20/25	m ³	208
5	Struktura monolite te holla betoni C – 25/25	m ³	25.2
6	Furr. Vend. Hekur betony ϕ 6 ~ 10mm	tone	6.2
7	Furr. Vend. Hekur betony ϕ >12mm	tone	2.6
8	Furr. Vend. Konstruksione metalike te thjeshta	tone	14.1
9	Furr. Vend. Tuba plastic per betone ϕ =100mm	ml	200
10	Furr. Vend. Lande druri e rrumbullaket	m ³	4.2
11	Furr. Vend. Lande druri e sharruar	m ³	4.5
12	Shtrese urash me drrasa t = 50mm	m ²	590
13	Lyerje shtrese drrasash me solucione mbrojtse	m ²	590
14	Boji vaji siperfaqe metalike	m ²	470
15	Rrethim parmak ure me rrjet teli	m ²	256
16	Mbushje pas mureve me material shkembore	m ³	350
17	Shtrese çakulli t – 10~15cm ne dy anet e urave	m ²	560

DREJTORIA E P.ZH.T- se TROPOJË

Tek. Mustaf VATOCI

Ing. Egzon MUHAMETAJ

Ark. Hazir ISUFAJ

QERSHOR 2023